

INTERTEXTUALITY IN THE NOVELS OF FATOS ARAPI INTERTEKSTUALITETI NË NOVELAT E FATOS ARAPIT

Jehona RUSHIDI-REXHEPI¹

^{1*} Department of Teacher Education, Faculty of Pedagogy, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: jehona.rushidi@unite.edu.mk

Abstract

Fatos Arapi is one of the contemporary authors who is mainly mentioned with his poetry. This paper aims to address an aspect which is not at all studied in his prose, concretely, reading from the point of view of the theory of intertextuality. The focus will be directed on his prose, such as: "I died on the banks of the Ionian" (Unë vdiqa në brigjet e Jonit), "Husk of snow" (Cipa e dëborës) and "Marko Bocari of the Suljots" (Marko Boçari i Suljotëve). The aim is to underline the relations that text opens to previous texts. Furthermore, will be shown the ways of signaling the presence of intertextual relations and the application of terminology deriving from the theory of intertextuality over concrete examples. In presenting these, the paper will also note the text's relationship to history and folklore. The phenomenon of citation, finding examples and classifying them, will be realized within intertextual relations.

Key words: *Fatos Arapi, intertextuality, citation, novels.*

Përmbledhje

Fatos Arapi është një nga krijuesit bashkëkohorë i cili kryesisht përmendet me poezinë e tij. Ky punim synon të trajtojë një aspekt deri tani pak ose aspak të prekur në prozën e tij, konkretisht të lexuarit nga këndvështrimi i teorisë së intertekstualitetit. Fokusi do të orientohej në krijimet e tij në prozë, siç janë: "Unë vdiqa në brigjet e Jonit", "Cipa e dëborës" dhe "Marko Boçari i Suljotëve". Synimi është që të nënvijëzohen relacionet që teksti i hap lidhur me tekste të mëparshme. Gjithashtu, do të paraqiten edhe mënyrat e sinjalizimit të pranisë së relacioneve intertekstuale dhe aplikimi i terminologjisë që del nga teoria e intertekstualitetit mbi shembuj konkretë. Duke i paraqitur këto, punimi do t'i nxjerrë në dukje edhe relacionet e tekstit me historinë dhe folklorin. Fenomeni i citatshmërisë, gjetja e shembujve dhe klasifikimi i tyre do të realizohet duke u nënkuptuar brenda relacioneve intertekstuale.

Fjalët kyçe: *Fatos Arapi, intertekstualiteti, citat, novelë.*

1. Hyrje

Krijimtaria e Fatos Arapit në krahasim me krijimet e shkrimtarëve të brezit të tij, lë përshtypjen se është prekur pak në studimet e letërsisë shqipe. Në veçanti e theksojmë këtë nëse e kemi parasysh prozën e tij. Meqenëse viteve të fundit gjithnjë e më shumë krijimi letrar analizohet nga këndvështrimi i kujtesës së tekstit si dhe lindjes së tij në rrugë kryqëzimesh, u pa e arsyeshme dhe sfiduese që edhe proza e këtij autori të studiohet në një mënyrë të këtillë.

Në këtë punim janë përzgjedhur tre krijime, si p.sh.: “Unë vdiqa në Brigjet e Jonit”, “Cipa e dëborës” dhe “Marko Boçari i Suljotëve”. Në këto novela, pavarësisht se që në titull e gjejmë edhe ngacmimin e parë intertekstual/paratekstual, kërkimet do të orientohen në drejtim të brendisë së tekstit të tyre, duke kërkuar lidhje intertekstuale që do të lindin, duke u nisur nga ato më të hapurat e deri tek ato më latentet. Brenda novelave të numëruara më sipër, do të jemi të vëmendshëm të nënvijëzimeve edhe shembuj të citateve.

Ky nënvijëzim do të realizohet duke ilustruar shkallën e sinjaleve të tyre, duke gjetur dallimin mes citateve të jashtme dhe të brendshme, shkallën e përputhjes, llojin (të vërteta ose të rrejshme). Mes tjerash, do të bëhet edhe veçimi i tyre varësisht nëse ato janë intrasemiotike ose intersemiotike. (Oraiç-Toliç, 1990). Të gjitha këto pikënisje të numëruara, mbështeten në vetëdijen postmoderne mbi letërsinë, si krijim që: *nuk mundet të lindë nga hç-i ose që lind aty ku kryqëzohen dy rrafshet*.

Madje, edhe kuptimi për intertekstin ndryshon varësisht nga thellësia e të lexuarit. Fillimisht kuptohet si lidhje që është më e shprehur, që jep mundësinë e krahasimit të palëve në dialog, por e cila më vonë mund të dalë si aluzion në të cilin edhe pikat më të zbehta kthehen në sinjale aktive. Për të qenë të drejtpërdrejtë, me rëndësi është të gjejmë kahjet e orientimit dhe teknikat që teksti zgjedh për ta vendosur këtë komunikim. Studimet bashkëkohore të letërsisë, jo që vetëm vështirë është të mendohen duke e vrojtuar veprën letrare si sistem të mbyllur dhe origjinal në kuptimin e ngushtë të fjalës, por edhe synojnë parashtrimin e thelluar të kësaj teorie të ndërlikuar.

2. Metodat

Punimi është sintezë e pjesës teorike dhe aplikative. Aty përmenden përfundimet më të rëndësishme teorike lidhur me teorinë e intertekstualitetit dhe asaj të citatshmërisë duke i parashtruar nëpërmjet shembujve konkretë. Qasja e analizës letrare do të jetë e jashtme dhe e brendshme, ndërsa plani i ndjekur është i natyrës deduktive.

3. Studimet paraprake

Pikënisja e këtij punimi është e bazuar në mungesën e studimeve konkrete intertekstuale në prozën e Fatos Arapit. Megjithatë, duhet theksuar se në fushën e kërkimeve letrare që i bëhen letërsisë sonë në përgjithësi, kanë filluar të marrin vend të posaçëm hulumtimet e bazuara në teorinë e intertekstualitetit. Pavarësisht asaj, krijimtaria e Fatos Arapit kryesisht studiohet duke u bazuar në poezinë e tij. Për prozën e Fatos Arapit gjejmë studimin monografik “*Fatos Arapi, nostalgjia për absoluten*” (Velaj, 2022), i cili dukshëm mundet të jetë mbështetje e studimeve të reja mbi prozën e tij.

4. Raportet intertekstuale në novelat e Fatos Arapit

“Unë vdiqa në Brigjet e Jonit”

Tema e detit që përmendet që në titull na rikthen në poezinë e tij, mirëpo nuk arrin të marrë rol autocitati. Lidhjet që hap teksti në këtë rast janë ato që do t'i cilësojmë si *aluzion* në shkrimet e tij, ku Jon-i është vetë pjesë e përjetimit. Novela “Unë vdiqa në Brigjet e Jonit” ka një notë të theksuar filozofike dhe një përpunim të hollë të personazhit. Rugët e arritjes së këtyre efekteve në novelë shtohen përmes ndërlidhjes tekstuale. Për të qartësuar, këtu ndeshemi me fenomenin e tekstit në tekst, rast ky ku teksti i Fatos Arapit është teksti kornizë brenda të cilit funksion teksti i brendshëm: “Sapo shkova dorën nën përkesë, takova atje librin e vogël,

që e kisha lënë qysh mbrëmë. Ishte drama “Ngjarje në Vishy” e Milerit. Unë nisa të lexoj” (Arapi, 1993, f. 15).

Raportet që teksti hap këtu nuk janë parodike, por janë afirmative, gjegjësisht titulli i veprës së Milerit është citat i plotë. Në novelë, teksti në tekst paraqitet edhe në variant tjetër. Meqë librat flasin për libra, fragmentin e mëposhtëm do ta kishim përkufizuar si shembull metateksti: “Atë mbasdite unë lexova dramën dhe në fletoren e shënimeve shkrova: Arthur Miler “Ngjarje në Vishy”. Tre momente që më mbërthejnë I.-Jo skena për jetën por jeta-skenë. Kudo ndihet pushteti i autorit që i bën të lozin, por kjo lodër është tmerrësisht jetësore. Vetë jeta loz. Dhe loz një lojë të tmerrshme, çnjerëzore, tragjike... (Arapi, 1993, f. 16).

Këta shembuj na orientojnë në shenjëzim të sistemit të brendshëm të komunikimit dhe atë të jashtëm, për të cilin flet studiuesi Ulrih Brojh. Ai fillimisht ndalet në sistemin e parë, jep shembuj duke theksuar edhe formën më ekstreme të shenjëzimit të relacionit intertekstual, atë të paraqitjes në vepër të personazheve nga vepra të tjera dhe duke përgjithësuar shprehet: “...shenjëzimi mund të bëhet edhe në sistemin e brendshëm të komunikimit, me atë që personazhët e një teksti letrar lexojnë tekste tjera, diskutojnë për ato, identifikohen me ato ose distancohen nga ato. (Brojh, 2003, f. 151).

Shenjëzimin në sistemin e jashtëm komunikativ, Ulrih Brojh (Brojh, 2003) e sqaron duke marrë shembuj nga zgjedhja e emrave, citateve, kolazhit, nga vënia e kontekstit permanent të intertekstualitetit, duke e ndryshuar edhe nivelin e qartësisë së sinjaleve. Kur jemi te qartësia e sinjaleve, të theksojmë se edhe në fund të kësaj novele takojmë shembull të inkuadrimin të tekstit në tekst, me citat të rrejtshëm, të sinjalizuar:

“Shpresa Bardhi
Rr.. “Ditët e Djetorit”, 25
Burrel

Më ka marrë malli shumë. Mos e bëj marrë, kthehu. Vitin e Ri gëzuar...
Unë...” (Arapi, 1993, f. 43)

“Cipa e dëborës”

Teksti në tekst ka mënyra të ndryshme të paraqitjes së tij si fenomen në krijime letrare. Kështu, te “Cipa e dëborës” ndeshemi me rrëfimin brenda rrëfimit, që ka një kohë të brendshme, të ndryshme nga ajo e veprës. Rrëfimi bëhet nga narratorë të ndryshëm. Më i spikaturi është ai i Ajkunës dhe Boqarit. Këtu mund të themi që hasim më pak shenjëzim eksplícit e më shumë implícit. Herën e parë që paraqitet rrëfimi i brendshëm, jepet nga goja e njërit prej personazheve, Ajkunës, ndërsa më tutje, kufijtë e shenjëzimit të tekstit të dytë fillojnë të jenë të paqartë dhe të tipit të sistemit të brendshëm. Këtu strukturat rrëfimore ngatërrohen, me çka edhe kërkimi dhe gjetja vështirësohen. Fillimi i vendosjes së tekstit të dytë në formë rrëfimi duket kështu:

“...Unë e martova... Ashtu është. Unë... Asaj dite..” (Arapi, 1993, f. 48)

Lidhjen me letërsinë gojore në këtë prozë e gjejmë si ngacmim nga i njëjti personazh:

“Si buron burimi
Qumështi buroftë...
Pëshpëriti Ajkuna!” (Arapi, 1993, f. 86)

Citatet janë përsëri intrasemiotike, hiperteksti ka për hipotekst urimet tona burimore. Qëndrimi ndaj shtresës së parë tekstuale është afirmativ, ndërkohë që këtë lloj qëndrimi e hasim edhe te citatet e rrejtshme:

“M’u kujtua një këngë një populllore që, kur e kisha dëgjuar për herë të parë, isha ngjethur. “Kënga e pleqve”, kështu e quanin ata që e këndonin. Dhe tani, duke dëgjuar ata pleq, mua m’u kujtua ajo këngë:

As ja marrim dhe një herë
Këngës sonë të pleqve,
Me iso të vjetëve
Se atje ku shkojmë ne,
Duert mbyllen me buqicë,
E nër oda shtruarë
Me profka në duar,
Gjejmë ca fëmijë të vegjël.” (Arapi, 1993, f. 90)

Pavarësisht që nuk gjejmë tekst të dokumentuar që do të na orientonte në shkallë të transformimit, nuk mundemi të mohojmë që struktura tekstuale është ajo folklorike. Përveç kësaj, aluzionet zgjohen nga vetë atmosfera e vendeve ku njerëzit tubohen, te: “...oda shtruarë...” (Arapi, 1993, f. 90).

“Marko Boçari i Suljotëve”

Titulli i kësaj novele është eksplicit nëse flasim për dialogun që hap teksti. Marko Boçari i Suljotëve është figurë reale historike, me çka teksti letrar komunikon me historinë. Kënga e vendosur si tekst në tekst brenda kësaj proze, është hipertekst i këngës popullore mbi Marko Boçarin. Pavarësisht varianteve, transformimi tekstual është i drejtpërdrejtë me ndryshime minimale.

“Ngreu Marko trimëria,
Ngreu se thërret Greqia,
Të vijë Marko Shqipëria...” (Arapi, 1993, f. 113)

Ose

“Atëherë nga fundi i kolonës erdhi një zë burri që këndonte:

Ti more Foto Xhavella,
Seç na bëre em kapella,
Seç u premë e seç u vramë,
Sulë e shkretë ku e lamë.
Ali Pashait ja dhamë.
...” (Arapi, 1993, f. 107)

Prandaj, shembulli hipertekstual me ndryshime minimale dhe qëndrim afirmativ ndaj të parit mundëson të klasifikohet si citat i plotë. Momenti historik bëhet fikcion letrar, duke qenë pikërisht ai që lidh realitetin historik si kahje ndaj së cilës hapet teksti. Materiali tekstual, duke u mbindërtuar mbi historinë dhe folklorin, del si një montim që i afrohet *kolazhit* si teknikë. Duke pasur parasysh titullin *paratekstual*, mund të themi që shënime tjera paratekstuale, qofshin në këtë ose në novela tjera, si duket janë parë si të panevojshme.

Kjo na bën të mendojmë se për dallim nga periudhat tjera të letërsisë sonë, krijuesi tashmë është i vetëdijshëm për rolin e lexuesit, realizimin e kuptimit dhe *vdekjen e autorit*. Konkretisht, te kjo novelë, mungesa e shënimeve orientuese paratekstuale lexuesin e përgatitur nuk e lë duarbosh, gjegjësisht pa i kthyer sinjalet intertekstuale negative në pozitive. Kjo na përkujton në dallimet mes lexuesit të ditur dhe atij të rëndomtë. (Piegay-Gros, 2011).

Përfundim

Ky punim kishte për qëllim që t'i ilustrojë kahjet e komunikimit të tekstit. Duke u përqëndruar në tri novela të Fatos Arapit, brenda punimit nuk u trajtuan aspekte tjera të cilat nuk janë ngushtë intertekstuale. Si teori e kohës së postmodernizmit kjo teori tekstin e sheh si një mjedis të kuptimeve plurale, polivalente dhe si të hapur. Kjo hapje e tekstit dhe ndërlidhjet që i vë, na mundësuan që te novelat e Fatos Arapit të manevrojmë lidhur me gjetjet. Duke aplikuar terminologji që përdor teoria e lartpërmendur, u pa që atë e gjejmë të aplikuar si model: hipertekstualiteti, parateksti, aluzioni dhe kolazhi.

Duke qenë citatshmëria vetë teori dhe një lloj teknike intertekstuale, novelat e Fatos Arapit na dhanë mundësi të ilustrojmë shembuj të civateve: të plota, të rrejshme, të shenjëzuara dhe latente. Kryesisht shembujt e gjetur i përkisnin civateve intrasemiotike, d.m.th. i takonin artit të njëjtë. Punimi ishte një orvatje modeste për ta orientuar vëmendjen drejt një vrojtimi të ri të krijimtarisë në prozë të Fatos Arapit, me shpresë që në të ardhmen studimet e kësaj natyre të thellohen dhe të zgjerohen në tërë opusin krijues të tij.

Referencat

- [1]. Arapi, F. (1993). Unë vdiqa brigjeve të Jonit.
- [2]. Brojh, U. (2003). In K. Kulavkova, *Teorija na intertekstualnosta*. Skopje: Kultura.
- [3]. Oraïç-Toliç, D. (1990). *Teorija citatnosti*. Zagreb: GZH.
- [4]. Piegay-Gros, N. (2011). *Poetika e intertekstualitetit*. Prishtinë: Parnas.
- [5]. Velaj, A. (2022). Fatos Arapi, nostalgjia për absoluten.